



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2018, miratoi këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E LAPIDARIT KUSHTUAR TË RËNËVE FRANCEZË TË KFOR-IT

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it, në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 7499-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Varrezat, Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së këtij lapidari përkujtimor.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: lokacioni i propozuar në ortofoto dhe lapidari i propozuar për zhvendosje.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0134846/18, më 06.06.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

I Vendimit për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm ka pranuar kërkesën nga Ambasada e Francës në Prishtinë, për vendosjen e lapidarit kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it.

Sipas kërkesës në fjalë, një lapidar kushtuar të rënëve francezë të KFOR-it ndodhet në kampin ushtarak "Maréchal de Lattre në Tassigny" në fshatin Maxhunaj/Novo Sellë.

Ky lapidar përbëhet nga një bllok guri, mbi të cilin janë të vendosura dy pllaka përkujtimore. Që nga largimi i kontingjentit francez të KFOR-it në vitin 2014, Franca nuk ka bërë ndonjë homazh për ushtarët e vdekur francezë, meqë monumenti është në një kamp ushtarak, çasja është me rregulla të rrepta dhe e kufizuar, andaj Ambasada kërkon ta zhvendosë këtë monument, në mënyrë që homazhet në nderim të tyre të mund të bëhen jashtë këtij kampi ushtarak.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në bazë të kërkesës së lartpërmendur, ka identifikuar propozim-lokacionin për vendosjen e lapidarit, i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për varreza - konservimi dhe shndërrimi i tyre në park.


Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 7499-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Varrezat, Prishtinë.

Vendosja e lapidarit në përkujtim të ushtarëve francezë të KFOR-it, është propozuar të bëhet në lagjen "Arbëria 3", gjegjësisht në hapësirën e varrezave të komunitetit serb në Prishtinë, varrezat afër objektit të ri të Komunës dhe në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për vendosjen lapidarit sipas kërkesës së Ambasadës së Francës në Prishtinë.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset lapidari është sipërfaqe e gjelbëruar e lirë, dhe gjatë vendosjes së obeliskut duhet t'i kushtohet kujdes ambientit. Ky lapidar përbëhet nga një bllok guri, mbi të cilin janë të vendosura dy pllaka përkujtimore (ashtu siç shihet në foto).

Bashkangjitur:

- Ortofoto e lokacionit,
- Lapidari që do të zhvendoset.



Ortofoto e lokacionit;



Lapidari i propozuar
(Zhvendosja e tij nga Kampi ushtarak Maxhunaj në Prishtinë)